

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Republika popullore e protestës
ADRESA	https://top-channel.tv/2026/09/09/analiza-filip-cakuli-republika-popullore-e-protestes/
BURIMI	top-channel.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	9 shtator 2026, 13:06:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	9 shtator 2026, 12:58:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto den text_date. Dritarja: 9 shtator 2026, 12:57:00 UTC → 9 shtator 2026, 12:59:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	35d07b412bddfe378bf0d46a977bb13abf5ec30c8e5afe3157c8607fab3c70b6
TEKSTI	fac3c5c13a98e018fc1fa5a72a1d85a81eb6f8668932df8381856f4f166da30b
PAMJA	e9ee6c1eb806c4d2bdc2e850ea58fd9f7b45b8b6da22fdf5b2a191253c2715e3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1cde7e786dcea7eb8bbf65880772961c49cc4cb08f49727a20140a23550e6fad
E MËPARSHMJA	56041e3df38ae0316bd89abc84a5aeba4da540698e44e50711d7ef63f1a036a0
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1cde7e786dcea7eb8bbf65880772961c49cc4cb08f49727a20140a23550e6fad>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px



- [Lajme](#)
- [Video](#)
- [Sport](#)
- [Pop News](#)
- [Programe](#)
- [Youtube](#)
- [Top News LIVE](#)

Accessibility options



- [Lajme](#)
- [Lajmet e fundit](#)
- [Politikë](#)
- [Kronikë](#)
- [Aktualitet](#)
- [Ekonomi](#)
- [Sociale](#)
- [Video](#)
- [Top News LIVE](#)

- [Bota](#)
- [Opinion](#)
- [Koment](#)
- [Kosova dhe Rajoni](#)
- [Shkencë dhe Teknologji](#)
- [Auto](#)

- [Video](#)
- [Programe](#)
- [Lajme](#)

- [Sport](#)
- [Kombëtarja](#)
- [Kategoria Superiore](#)
- [Kategoria e Parë](#)
- [Premier League](#)
- [La Liga](#)
- [Serie A](#)
- [Shumësportësh](#)
- [Sport Gossip](#)

- [Pop News](#)
- [Showbiz](#)
- [Lifestyle](#)
- [Fashion](#)
- [Shëndeti](#)
- [Dieta](#)
- [Receta gatimi](#)

- [Programe](#)
- [Big Brother VIP](#)
- [Për'puthen](#)
- [Shqipëria LIVE](#)
- [Fiks Fare](#)
- [Video](#)
- [Të gjitha programet](#)
- [Guida TV](#)

- [Top Channel](#)
- [Rreth Top Channel](#)
- [Bileta](#)
- [Kontakt](#)
- [Puno në Top Channel](#)
- [Privacy Policy & Terms of Use](#)
- [Aksesueshmëria](#)

Kërko...

[Opinion](#)

Republika popullore e protestës

09/09/2026 18:58



Nga Filip Çakuli

Dua ta theksoj që në fillim, se jam përkrahës e mbështetës i çdo lloj proteste, jo vetëm me dhjetra, qindra e mijëra pjesëmarrës, po qoftë dhe një protestues i vetëm. Sepse është një nga mrekullitë e demokracisë. Por, nuk mund të pajtohem me dhunën, me anarshinë dhe banalitetin, që nuk dëshmon qytetari, po rrugaçeri. Më nxitë për të hedhur këto shënime akti i një vajze të re, ndaj një zonje të nderuar, me fyerje, me sharje dhe me akuza, si hajdute. Zonja dinjitoze nuk ktheu përgjigje. Po të isha unë, do t'ia kisha treguar, sa i vlen lëkura...

Ku sovranë matet me decibel, opozita me vezë dhe demokracia me rrugë të bllokuara Shqipëria është demokraci. Dhe prova më e madhe se është demokraci është se, sa herë bëhet një protestë, pjesa tjetër e qytetit nuk lejohet të lëvizë. Sepse demokracia jonë funksionon thjesht:

Unë kam të drejtë të protestoj.
Ti ke të drejtë të presësh në trafik.
Unë kam të drejtë të bllokoi rrugën.
Ti ke të drejtë të fikësh motorin.
Unë kam të drejtë të ulëras.
Ti ke të drejtë të dëgjosh.
Barazi e plotë!

Tirana ka shesh para Kryeministritë. Ka bulevard. Ka sheshin "Skënderbej". Por këto nuk mjaftojnë. Protestuesi shqiptar nuk kërkon shesh. Kërkon kryqëzim. Sepse çfarë proteste është ajo ku qytetari kalon normalisht me makinë? Duhet bllokuar rruga. Ndryshe Rama mund të mos e marrë vesh që je zemëruar. Në fakt, Rama mund të jetë në zyrë duke pirë kafe, ndërsa ti ke bllokuar një hidraulik nga Kombinati, një infermiere që po shkon në turn dhe një nënë që po merr fëmijën nga kopshti. Qeveria vazhdon punën. Qytetari dënohet. Revolucion perfekt!
Po policia?
Policia është aty. Sheh. Vëzhgon. Kujdeset që protesta të zhvillohet normalisht. Pra që bllokimi të vazhdojë pa u bllokuar.

Polici sheh qytetarin që nuk kalon dhe protestuesin që nuk e lë të kalojë dhe, me sa duket, mendon:

— Të du kanë të drejta. Vetëm njëri ka rrugën

— Ky mund të shpëtoj vetëm nga na regam!

Në këtë pikë qytetari mund t'i drejtohet policit:

— Zotëri, dua të kaloj.

— Nuk mundesh, ka protestë.

— Po unë protestoj kundër bllokimit të rrugës.

Këtu sistemi pëson kolaps. Sepse kemi protestues kundër protestuesit. Kush ka përparësi?

Kodi Rrugor nuk e ka parashikuar.

Pastaj fillon demokracia ushqimore.

Veze! Domate! Miell!

Deputeti del nga Kuvendi dhe nuk e di nëse po shkon në shtëpi apo po hyn në sallatë.

Një vezë nga e majta. Një domate nga e djathta. Pak miell nga qendra. Edhe dy kastravecë dhe kemi reformën zgjedhore.

Kjo është faza më e lartë e debatit politik shqiptar:

Kur mbarojnë argumentet, hapet frigoriferi.

Deputeti thotë:

— Kam mandat nga zgjedhësit!

Protestuesi:

— Prit se kam edhe gjashtë vezë!

Dhe fiton ai që ka rutinë më të madhe.

Monteskjeja foli për ndarjen e pushteteve. Ne kemi bërë një përmirësim:

Legjislativin, ekzekutivin dhe bulmetin.

Pastaj vjen kultura qytetare. Turma nis në kor:

“Edi Rama, të q... robtë!”

Në mes të Tiranës. Me gra. Me të moshuar. Me fëmijë.

Ndonjë prind mund t'i ketë thënë fëmijës para se të dalë nga shtëpia:

— Mos thuaj fjalë të pista se është turp!

Pastaj e merr për dore dhe e çon në protestë:

— Tani dëgjo xhaxhallarët si bëhet demokracia.

Fëmija kthehet në shtëpi me një edukim të plotë qytetar.

Të nesërmen në shkollë mësuesja e pyet:

— Çfarë mësove dje për demokracinë?

— Mësova robtë e Kryeministrit.

Edukimi qytetar, kapitulli VII.

Pastaj vjen kryevepra: “Edi Rama, o legen, gjithë Shqipëria të urren!”

“Gjithë Shqipëria”?!

Këtu ndalemi. Sepse sapo ndodhi një mrekulli statistikore. INSTAT-i mund të mbyllet.

Nuk duhen më anketa. Nuk duhen zgjedhje. Nuk duhen sondazhe.

Mjaftojnë një mikrofon, një altoparlant dhe 500 veta që bërtasin fort.

Dhe u krye: Shqipëria foli!

Po ai shqiptari në Shkodër që nuk është aty?

E urren.

Ai në Korçë?

Edhe ai.

Ai në Vlorë që po ha peshk dhe s'e ka mendjen fare te protesta?

E urren patjetër.

Po ai që e voton Ramën?

Edhe ai e urren.

Nuk e di akoma, por protesta ia ka sqaruar.

Madje protestuesi nuk përfaqëson vetëm ata që janë gjallë.

Me pak entuziazëm mund të deklarojë:

“Të gjithë shqiptarët, brenda dhe jashtë vendit, të gjallë dhe të vdekur, kërkojnë largimin e qeverisë!”

Kjo puna e të folurit në emër të popullit është magjepsëse.

Del një zotëri me mikrofon:

“POPULLI KËRKON!”

Cili popull?

— Populli!

Sa veta?

— I gjithë populli!

Po kush të autorizoi?

— Populli!

Ku?

— Këtu!

Po këtu janë 2 mijë veta.

— Janë përfaqësuesit e popullit!

Kush i zgjodhi?

— Vetë populli!

Kur?

— Mos provoko!

Këtu mbyllet teoria politike.

Në fakt, protestuesi mund të flasë me plot të drejtë në emër të vetes: “Unë dua që Rama të ikë.”

Shumë mirë.

Mund të flasë edhe bashkë me të tjerët: “Ne duam që Rama të ikë.”

Shkëlqyeshëm.

Por kur thotë: “SHQIPËRIA DO QË RAMA TË IKË!”, atëherë ka bërë një hap të vogël nga protestuesi dhe një hap të madh drejt pronarit të Shqipërisë.

Madje as për familjen e vet nuk mund të jetë gjithmonë kaq i sigurt.

Mund të bërtasë: — Familja ime e urren Ramën!

Dhe nga shtëpia t'i telefonojë grua:

— Fol për vete, se unë e votova!

Demokracia ka një defekt të tmerrshëm: Edhe ai që nuk mendon si ti është qytetar. Edhe ai që nuk proteston është popull. Edhe ai që voton kundër teje është shqiptar.

Madje skandal i vërtetë edhe ai që voton Ramën ka pasaportë shqiptare.

Kjo e komplikon shumë revolucionin.

Sepse do të ishte shumë më praktike sikur “popull” të quheshin vetëm ata që janë në protestë.

Të tjerët mund t'i quanim: “popull teknik”.

Prandaj propozoj që protestat e ardhshme të organizohen me rregulla të qarta.

Në hyrje të shpërndahen: një pankartë, një bilbil, dy vezë, një domate, dhe një certifikatë:

“Mbajtësi i këtij dokumenti autorizohet të flasë në emër të 2.4 milionë shqiptarëve.”

Për protestuesit më aktivë mund të jepet edhe licenca premium:

“Lejohet bllokimi i kryqëzimeve, sharja kolektive dhe përdorimi i produkteve bujqësore kundër deputetëve.”

Ndërsa policia të pajiset me një tabelë të madhe: “QYTETARË, MOS U SHQETËSONI. RRUGA ËSHTË E BLOKUAR NË EMËR TË LIRISË SUAJ.”

Sepse protesta është e shenjtë në demokraci. Por demokracia nuk është: Unë protestoj, prandaj ti hesht.

Nuk është: Unë jam 5 mijë veta, prandaj jam 2.4 milionë.

Dhe sidomos nuk është: Unë kam mikrofonin, prandaj jam populli.

Se po qe kështu, nuk na duhen më zgjedhje. Blejmë një palë altoparlantë më të fuqishëm. Dhe kush bërtet më fort... merr qeverinë.

Top Channel

[Opinion »](#)



[Ullishtja kombëtare e pronësisë shqiptare](#)

[11/09 15:51](#)



[Sa të interesuar janë adoleshentët shqintarë nër nolitikën?](#)

09/09 17:12



Dorëheqja shakullimë e ministres Evis Sala

08/09 14:16



“Trajtimi i Mlladiçit në Serbi: Ironi e madhe, po, çudi jo!”

08/09 11:35



Kujt ka gjasa t’ia japin votën banorët e rritur të bashkive që do të zgjerohen

07/09 18:27



Reportazh/ Nga gjurmët e Krugës Egnatia te varret monumentale të Selcës së Poshtme dhe letra e kolonelit francez, përse Podradeci po josh turistët

05/09 10:10

Na ndiqni:

Top Channel @topchannelalbania @tchbreakingnews Top Channel

Video »



Top News- Tjetër tragjedi në familjen mbretërore, pas mbretit vdes princesha



Top Channel/ “E përpiu pushteti, nuk ishte hakmarrje e imja”, Rama për Metën: Ishte talent politik



Top Channel/ “Balluku kontrollon qeverinë?”, Kryeministri Rama: Këto janë barcoleta Tirane



Top Channel/ “SPAK hyri në territorin tim me Ballukun”, Rama: Veliaj është rast tjetër



Top Channel/ “Kisha investuar në një maskë karnavalesh”, Rama për Ahmetajn: E dhimbshme, por...



Top Channel/ “Tirana është...”, Rama: Problematikat që ngre Braçe janë të lidhura me bashkinë

Kryesore

“Veliaj në burg, absurd i kryeqytetit”, Rama për hetimet ndaj Belinda Ballukun: Nuk e mbron askush, çështjen e ka me drejtësinë

21:21

Ndryshimet në ministrinë e Punëve të Brendshme, reagon Rama: Lamallari do i bashkohet ekipit tim në Kryeministri

10:19

Dyshimet për rrëmbim dhe tetë vite pa përgjigje, Elvis Troqe shpallet zyrtarisht i zhdukur

11:38

Rriten tensionet për Ishujt Falkland, presidenti i Argjentinës anulon vizitën në Mbretërinë e Bashkuar

09:28

Ekskluzive/ Goditje për Kombëtaren, Strakosha me frakturë në dorë, mungon në 4 sfidat e Nations League

21:39

Më të lexuarat

Kryeministri Rama liron nga detyra ministrin e Brendshëm, Besfort Lamallari, Ervin Demo merr postin e tij

Prishet moti/ Rikthehen reshjet e shiut dhe shtrëngatat, si parashikohen temperaturat për fundjavën dhe ditët në vijim

Detaje tronditëse nga vdekja e papritur e Mazonakis/ Pasi u ‘ngeli në dorë’, mjekët kërkonin në ChatGPT si ta rikthenin në jetë, i bënë edhe foto

Ndryshimet në ministrinë e Punëve të Brendshme, reagon Rama: Lamallari do i bashkohet ekipit tim në Kryeministri

Profil/ Zëvendëson Lamallarin si ministër i Brendshëm, Nga bashkia e Beratit në Pushtetin Vendor, kush është Ervin Demo

Administrativja zhbllokoi pagat, ironizon Rama: Shqiptarët do u falnin gjysëm rroge gjykatësve, po të kishin të njëjtin standard për hallet e tyre

Pas betimit si ministre, Spahiu ndan detyrat te Shëndetësia: Që nga nesër në orën 08:00 do hapet një zyrë për problemet e qytetarëve

Pas mbledhjes së qeverisë, ministrat zbardhin vendimet: 110 mln euro me Gjermaninë, 7 mijë apartamente dhe fond për energjinë

Vila e sekuestruar në Palasë/ Anila Hoxha zbardh dosjen në Shqipëria Live: SPAK thotë se i përket Ballukut, emaili që çoi hetuesit të pasuria

Tensionet përshkallëzohen në Lindjen e Mesme, SHBA dërgon trupa në Arabinë Saudite për luftën kundër Houthisve

- Lajme
- Lajmet e fundit
- Politikë
- Kronikë
- Aktualitet
- Ekonomi
- Sociale
- Video
- Top News LIVE

- Bota
- Opinion
- Koment
- Kosova dhe Rajoni
- Shkencë dhe Teknologji
- Auto

- Sport
- Kombëtarja
- Kategoria Superiore
- Kategoria e Parë
- Premier League
- La Liga
- Serie A
- Shumësportësh
- Sport Gossip

- Pop News
- Showbiz
- Lifestyle
- Fashion
- Shëndeti
- Dieta
- Receta gatimi

- Programe
- Big Brother VIP
- Për'puthen
- Shqipëria LIVE
- Fiks Fare
- Video
- Të gjitha programet
- Guida TV

- Top Channel
- Rreth Top Channel
- Bileta
- Kontakt
- Puno në Top Channel
- Privacy Policy & Terms of Use
- Aksueshmëria

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.